



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot

Data ____/____/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS “Blerje paisje dhe materiale ne kuader te projektit Pro Light Med”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 1681410-0;

VLERA E FONDIT LIMIT: 23,333,260 (njetet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtedhjetë) Lek pa Tvsh ose 242,650.37 (dyqind e dyzet e dy mijë e gjashteqind e pesedhjetë pike tridhjetë e shtatë) Euro pa Tvsh.

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 14/01/2026 është 96.16 Lekë.

ARGUMENTIMI I NJESISE PER MOS NDARJEN ME LOTE TE PROCEDURES:

Duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor Bashkia Lezhe argumenton mosndarjen e procedures në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Kjo procedurë është vlerësuar te mos ndahet ne lote pasi, kemi të bëjmë me blerjen e disa mallrave te cilet nevojitet furnizim i vazhdueshem dhe me te njejtin mall.

Theksojme se, ndarja me lote mund te sjelle lidhjen e kontratave me disa operatore ekonomike dhe do te krijonte nevojen per angazhimin e burimeve njerezore shtese duke sjelle kosto shtese per Autoritetin Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar menyren e prokurimit e hapur mbi kufirin me lare monetar me qellim furnizimin dhe manaxhimin e procesit te administrimit dhe marrjes ne dorezim te mallrave duke angazhuar sa me pak burime njerezore, pasi furnizimi nga shume operatore kerkon angazhim me te larte dhe krijon konfuzion ne perocesin e administrimit dhe marrjes ne dorezim.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 prashikohet shprehimisht se:

“Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Theksojmë se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratës dhe shpërndarjen e përgjegjësiave duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës. Në këto kushte, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me legjislacionin.

Ne vijim AK, në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Kjo pikë e kriterëve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ vecanta të kualifikimit të plotësuar më sipër. (Shtojcat).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar dhe kerkohet nje operator ekonomik i cili te kete minimumin e kerkuar duke marre ne konsiderate objektin e kontrates.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës **31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Sa me siper, Njesia e Prokurimit duke mbajtur ne konsiderate parashikimet ligjore te sipercituarra dhe afatin qe parashikohet per publikimin e kontrates, vendosi qe te kerkoje vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, meqenese operatoret ekonomike kane afat dorezimi te deklarates vjetore te vitit 2025 deri me 31 mars 2026. Kjo kerkese e NJ.P vjen me qellim per tu dhene mundesi te gjithë operateve ekonomike per pjesemarrje te cilet mund te mos kene dorezuar deklaraten vjetore ne organet tatimore per vitin 2025.

2.2.2 Operatoret Ekonomike ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe keto fatura të jone të deklaruara në organet tatimore.

ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe keto fatura të jone të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të kenë të punësuar të paktën **3 (tre) punonjës** për periudhën **Tetor 2025-Dhjetor 2025**, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Tetor 2025-Dhjetor 2025**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Tetor 2025-Dhjetor 2025**.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është

dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (nje) mjet transporti me kapacitet mbajtes deri në 3.5 ton, në pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi për transportin e mallrave deri në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

- Për të provuar disponimin e mjeteve të kërkuara, OE duhet të paraqesë:

a- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, siguracion, taksa, pronësia).

b- Për të konfirmuar disponibilitetin e mjetit të marre me qira ose kontrate bashkepunimi, krahas dokumentacionit të mesipër duhet të paraqiten edhe Kontrate e qirase/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qera ose kontrate bashkepunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar mallrave sipas preventivit dhe specifikimeve teknike. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/ distributorin e autorizuar për mallrat sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emertimi
1	Ndricues rrugor 85 w
2	Koke ndricusi urban 41 w
3	Automat 16A, 1P,
4	Shtylla metalike per ndriçim H=7m, d=160mm
5	Krah shtylle metalike KRH-MSI 1500/1500/10
6	Tub kavidoto D.63mm
7	Kabull Φ(4x10mm) Al

Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar, për materialet e sipërcituara.

Argumentimi: 2.3.4, Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

b) *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

8. *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

Sa me sipër shfaqet e nevojshme që për mallrat objekt prokurimi, të paraqiten Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produktit me specifikimet teknike dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor sigurohet mbi origjinalitetin e mallit.

Në lidhje me këto kritere NJ.P. gjykon se janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me artikullin e kerkuar.

Akoma më tej NJ.P. gjykon se dokumentat e kërkuar Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar, raport analizat mund të sigurohen lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre furnizimin me këto kategori produktesh për të cilat kanë për detyrë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e tyre dhe të dhenat teknike për këto produkte. Po ashtu me këto kriter të vendosur, autoriteti kontraktor nuk ka tejkaluar objektin e prokurimit pasi për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet “mall”, sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalog/fragment katalogu/skeda teknike për mallrat sipas tabelës së mëposhteme:

Nr.	Emertimi
1	Ndricues rrugor 85 w
2	Koke ndricusi urban 41 w
3	Automat 16A, 1P,

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se:

-40/6 “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

-40/8 “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Sa me sipër shfaqet e nevojshme që për mallrat objekt prokurimi, të paraqiten katalog/fragment katalogu/skeda teknike, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produktit me specifikimet teknike.

Në lidhje me këto kritere NJ.P. gjykon se janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me artikullin e kerkuar.

Akoma më tej NJ.P. gjykon se dokumentat e kërkuar katalog/fragment katalogu/skeda teknike mund të sigurohen lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre furnizimin me këto kategori produkte për të cilat kanë për detyrë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e tyre dhe të dhënat teknike për këto produkte.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të gjithë sasisë së mallit të përfshirë në këtë procedurë prokurimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.3.7 Ditën dhe orën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Nga 1 (nje) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Ndricues rrugor 85 w	cope	1
2	Koke ndricusi urban 41 w	cope	1
3	Kabull ABC alumini 4X16mm	ml	1
11	Automat 16A, 1P,	cope	30
19	Krah shtylle metalike KRH-MSI 1500/1500/10	cope	1

- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave sipas DST-se, pranë magazines se Drejtorise se shërbimeve Publike, te Bashkise Lezhe me adrese: Rruga Vellezrit Coku, Ish SMT, Lezhe.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.
- Mostrat duhet të jene në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. 38 Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit”

Ne lidhje me kërkesën për paraqitjen e mostrave Autoriteti Kontraktor thekson se për mostra janë perzgjedhur disa nga mallrat me të rëndësishme bazuar në vlerën e produktit, sasitë me të larta, si dhe në përdorimin e tyre pasi ndikojnë ndricimin e rrugëve dhe shikueshmerinë tyre në oret e nates.

Theksojmë se Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar qartë adresën dhe oren e paraqitjes së mostrave për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

Sqarim: *Ne çdo rast që mund të përmendet në preventiv emer marke/prodhuesi ose "Importi", "Cilësi e I-rë", do të pranohet edhe ekuivalenti i tij.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia përgjegjëse citon se ka hartuar specifikimet teknike, ku janë shprehur qartë kërkesat AK për realizimin e kontratës.

Njesia përgjegjëse në specifikimet teknike argumenton se nuk ka përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me

parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT: